



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 18.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **15.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Besa Security**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime”** me Nr. të Prok: 206-24-2841-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **APROVOHET** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Besa Security** dt. 15.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me Nr. të Prok: 206-24-2841-2-2-1, kundër Njoftimit për Kontrate të Autoritetit Kontraktues të datës 26.03.2024 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Ndryshohet**, Njoftimi për Kontrate i datës 26.03.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përmirësimet e nevojshme përmes Formularit standard për Korigjim të procedurës;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Besa Security me datë 15.04.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me Nr. të Prok: 206-24-2841-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 18.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime

Pretendimi ankimore

Neni 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime

Te nderuar,

Keni kërkuar ne DT ne lidhje me pagën e punëtorit "Operatori ekonomik duhet te deklarohet se paga për një punëtorë duhet të jetë jo me pak se 350 euro neto."

Dhe buxheti i parapare ne vlere prej 80,000.00€

Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite te javës, Sipas Ligjit nevoiten 4 punetore.

Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës.

Sipas Ligjit duhet te respektohen shtese, oret e nates, oret e festave, pushimi vjetor etj.

Dhe sipas nje kalkulimi te shpejt ku duhen te mbulojen te gjitha shpenzimet e punetoreve per kete aktivitet te prokurimit me kohezgjatje te kontrates 36 muaj, tejkalohe vlera e parapare nga ju.

Andaj kerkojm nga ju te na sqaroni se si keni ardhur ne perfundim me buxhetin e parapare?


Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Ne lidhje me pretendimin ankimor, Ministria e Shëndetësisë ka shqyrtuar pretendimin dhe ka vërejtur se është bere gabim gjate kalkulimit te vlerës se parashikuar. Ne lidhje me këtë, Ministra e Shëndetësisë do te ndërmer te gjithë hapat e nevojshëm për përmirësim te procedurës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit